

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përberë nga gjyqtaret: Enver Peci, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Emine Kaçiku, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, si procesmbajtës, ne kontestin administrativ te paditësit N. D., nga Prizreni kundër te paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës ne Prishtine, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor te paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit te Gjykatës se Apelit te Kosovës, AA.nr.316/2015 te datës 27.01.2016, ne seancën e kolegjit te mbajtur me 28.04.2016, mori këtë

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e paditësit N. D., nga Prizreni për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor e parashtruar kundër aktgjykimit te Gjykatës se Apelit te Kosovës, AA.nr. 316/2015 te datës 27.01.2016.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e atakuar te Gjykatës se Apelit te Kosovës, AA.nr.316/2015 te datës 27.01.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit N. D., nga Prizreni dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtine-Departamenti për çështje administrative A.nr.1324/2015, i datës 15.10.2015.

Paditësi kësaj gjykate ne afat ligjor i ka parashtrua kërkesë për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësorë, me te cilën ne tersi konteston ligjshmërinë e aktvendimit te cekura me lart me propozim qe te aprovohet kërkesa për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor dhe aktgjykimi i Gjykatës se Apelit, AA.nr. AA.nr. 316/2015 te datës 27.01.2016, dhe ai i Gjykatës Themelore ne Prishtine - Departamenti për çështje administrative A.nr.1324/2015, i datës 15.10.2015, te anulohen.

Gjykata Supreme e Kosovës ne baze te nenit 53 te Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit te aktvendimit te

atakuar, kërkesës se paditësit për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësorë dhe shqyrtimit te shkresave tjera te lendes ka gjetur se:

Kërkese është e pa bazuar.

Nga shkresat e lendes rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës se Apelit te Kosovës AA.nr. 316/2015 te datës 27.01.2016, është refuzuar si pa bazuar ankesa e paditësit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtine – Departamenti për çështje administrative A.nr.1324/2015, i datës 15.10.2015 është vërtetuar, me te cilën është refuzuar kërkesëpadia e paditësit N. D., nga Prizreni e ushtruar kundër te paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës ne Prishtine me te cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit te Komunës se Prizrenit, nr.03/726/12 i datës 08.10.2012.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit te aktgjykimit te kontestuar, shkresat e lendes dhe vlerësimit te pretendimeve ne kërkesë, gjeti se gjykata e shkalles se dyte drejt ka vepruar kur ka refuzuar si te pa bazuar ankesën e palës se paditur dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës se shkalles se pare.

Qëndrimin juridik te Gjykatës se Apelit si te rregullt dhe te bazuar ne ligj ne tersi e aprovon edhe kjo gjykatë, nga se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshi me shkelje te drejtës materiale e as te dispozitave procedurale siç pretendon paditësja ne kërkesë.

Sa i përket pretendimeve te paditëses ne kërkesë se, gjykatat e shkalles me te ulet kane arrit te përfundimi i gabuar se paditësi nuk e ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e paluajtshmeris duke konsideruar se ka pas dokumentacion te nevojshëm dhe se pengesa qe ka ekzistuar me masën e përkohshme është tërheq, një pretendim te till kjo gjykatë e refuzon si te pa bazë dhe te pa argumentuar nga se ne shkresat e lendes nuk ekziston ndonjë prove se masa e përkohshme e sigurimit e shqiptuar me vendimin e Gjykatës Komunale ne Prizren, C.nr.971/09 te datës 24.05.2010 është tërheqë. Ne baze te nenit 309 te Ligjit për Procedurën Kontestimore është parapa se masa e sigurimit e caktuar me vendim te gjykatës mbetet ne fuqi deri sa mos te jepet vendim tjetër mbi këtë mase. Ne shkresat e lendes nuk ka ndonjë provë se ne çështjen civile qe udhëhiqet ne Gjykatën komunale ne Prizren ka ndonjë vendim për

fatin e kësaj procedure e qe kontesti ka për baze juridike nulitetin te kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmerisë dhe dorëzimin e te njëjtës ne posedim. Pretendimi i paditësit se masa e përkohshme e sigurisë ka te beje me ndalimin e ekzekutimit te çfarëdo punimeve ne pjesën e parcelës kontestuese nga ana e paditësit N. D. dhe ndërhyrësve tjerë dhe se nuk paraqet pengës për bartjen - regjistrim te kësaj paluajtshmerie, sipas vlerësimit te kësaj gjykate është i pa baze. Masa e përkohshme e sigurisë ndalon ndryshimin e gjendjes ekzistuese dhe se me lejimin e regjistrimit te kësaj paluajtshmerie gjendja ekzistuese do te komplikohet edhe me tepër duke pas parasysh faktin se nuk kemi ndonjë vendim përfundimtar nga gjykata kompetente.

Nga te cekurat e mësipërme, Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e shkalles se pare dhe e dyte me aktgjykimet e tyre ne këtë çështje administrativo-juridike drejt kane aplikuar dispozitat e drejtës administrative, Ligjit për Konfliktet Administrative, Ligjit për Procedurën Kontestimore, Ligjit për Themelimin e Regjistrimit te Drejtave te Pronës se Paluajtshme, njashtu qe pretendimet e paditësit ne kërkesën për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor janë te pa bazuara, nga se nuk janë me ndikim ne vërtetimin ndryshe te gjendjes faktike nga ajo qe kane vërtetuar gjykatat e shkalles me te ulet. Sipas vlerësimit te kësaj gjykate, aktgjykimi i atakuar i shkalles se dyte është i qarte dhe i kuptueshme, ne arsyetimin e te njëjtit janë dhënë arsya te nevojshëm mbi faktet vendimtare te cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata vlerëson se edhe e drejta materiale drejt është aplikuar dhe se nuk është shkel ligji ne dëme te paditësit.

Nga si u tha me sipër, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVES

Me 28 prill 2016, ARJ.nr.16/2016

Procesmbajtësi,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Enver Peci